




FESTIVALI I ARTIT NË **HA** PËSIRË
PU BLIKE



1-5 GUSHT 2025
PRISHTINË — GJAKOVË
KOSOVË

EDICIONI I NJËMBËDHJETË





Hapu.me Gjakovën e Prishtinën dhe zhytu në lojë!

Të nderuar eksplorues të hapësirës publike,

HAPU po ndodh këtë vit për të njëmbëdhjetën herë! Përveç Prishtinës, po hapemi edhe në Gjakovë duke bashkëpunuar me Iniciativën e Fondacionit "Për Gjakovën". Kemi shtrirë programin tonë më 1 dhe 2 gusht në Gjakovë, e nga 2 deri më 5 gusht në Prishtinë. Kështu po zhytemi në lojën e artistëve nga Franca, Gjermania e Portugalia të cilët me mjeshtërinë e tyre të jashtëzakonshme do të transformojnë hapësirat publike në hapësira artistike, të guximshme, kreative e shumë dimensionale.

Elementet e cirkut bashkëkohor, do të hapin këtë edicion të festivalit, përmes një performance magjepsëse të Juan Ignacio Tula. Duke manipuluar me rrethin e madh dhe rrotullimet e tij pafund, frymëzuar nga rrotullimi i dervishëve, do të na zhysin në një përvojë të veçantë. Performanca na fton në një rrugëtim të përjetimeve universale e personale dhe gjithçka që ekziston ndërmjet tyre.

Bashkë do të palosin origami, por jo të zakonshme. Figura origami gjigande, të madhësisë reale të Frank Bölter, bashkërisht do i palosim. Krijimet tona origami do t'i përcjellim e festojmë me njëri-tjetrin dhe në fund, do t'i transformojmë, ripërdorim e riciklojmë.

Do të zhytemi në lojën e artistëve francez nga Tac o Tac, në kërcimet e tyre në kingalat me pneumatikë, do t'i përcjellim e do të ri-përfetojmë rrugët e Gjakovës dhe Prishtinës, në një atmosferë të tjetërsuar, në një ri-zbulim të qiellit, të gatshëm për fluturim.

Loja e Mimo's Dixie Band do të na sjellë tingujt e veçantë që do të na përfytyrojnë rrugët e vjetra të Nju Orlinsit. Do të na dhurojnë lojën e përbashkët me publikun, me elemente cirku e teatri si dhe me energjinë e tyre mahnitëse duke e sjellë publikun në qendrën e vëmendjes.

Jemi të lumtur që mund të organizojmë për ju një spektakël të veçantë në vendet e ndryshme të hapësirës së Prishtinës e Gjakovës, që të përjetojmë magjinë që artistët e sjellin duke na shndërruar hapësirat publike për ato çaste që do t'i kalojmë së bashku.

Hapuni, dilni dhe takoni artistët! Luani, përjetoni transformimin, bëhuni pjesë e këtij ri-zbulimi dhe dëshmitarë të mahnitjes.

Ju presim!

*Florent Mehmeti, Drejtor Artistik
HAPU – Festivali i Artit në Hapësirë Publike*



PROGRAMI GJAKOVË

E PREMTE, 1 GUSHT 2025

Ora	Programi	Lokacioni
19:30	Juan Ignacio Tula (FRANCË, ARGJENTINË) - L'INSTANT T! Një performancë e zhytur në një ekstazë. Një element i cirkut bashkëkohor - rrethi, si dhe rrotullimi i vazhdueshëm, fiksime të artistit, i inspiruar nga kërcimet rrotulluese të dervishëve.	GJ1: Parku Kulturor "Ali Podrimja" (Amfiteatri)

E SHTUNË, 2 GUSHT 2025

Ora	Programi	Lokacioni
11:00 deri 18:00	Frank Bölter (GJERMANI) - Origami së bashku Jeni të ftuar t'i bashkëngjiteni artistit për të krijuar një origami të madhësisë reale së bashku.	GJ1: Parku Kulturor "Ali Podrimja"
18:00	Ftoheni që të festojmë së bashku krijimin e përbashkët duke iu bashkangjitur performancës së artistit. Ejani dhe zbuloni çka është krijuar dhe çka do të ndodh.	
20:00	Krijimin e ditës do ta ri - transformojmë, ri - përdorim dhe ri - ciklojmë, duke ri - krijuar diçka të bukur bashkërisht.	
19:00	Tac o Tac (FRANCË) - Take Off Artistët nga Franca, mbi kingala me pneumatikë e me makinë gati - futuruese, ju ftojnë të ju bashkëngjiteni në një paradë që do të na shpije kah Qarshija e Madhe duke përjetuar qytetin në një atmosferë krejtësisht tjetër, në një ri zbulim qiellor, gati për fluturim.	GJ2: Afër Pallatit të Kulturës "Asim Vokshi" (Pika fillestare)

PROGRAMI PRISHTINË

E SHTUNË, 2 GUSHT 2025

Ora	Programi	Lokacioni
20:00	Juan Ignacio Tula (FRANCË, ARGJENTINË) - L'INSTANT ! Një performancë e zhytur në një ekstatë. Një element i cirkut bashkëkohor - rrethi, si dhe rrotullimi i vazhdueshëm, fiksimit i artistit, i inspiruar nga kërcimet rrotulluese të dervishëve	P1: Sheshi "Zahir Pajaziti" (Amfiteatri)

E DIEL, 3 GUSHT 2025

Ora	Programi	Lokacioni
19:00	Tac o Tac (FRANCË) - Take Off Artistët nga Franca, mbi kingala me pneumatikë e me makinë gati - futuruese, ju ftojnë të ju bashkangjiteni në një paradë që do të na shpije kah Sheshi "Zahir Pajaziti", nëpër Bulevardin "Nëna Tereza", duke përjetuar qytetin në një atmosferë krejtësisht tjetër, në një ri zbulim qiellor, gati për fluturim.	P2: Sheshi "Skënderbeu" (Pika fillestare)

E HËNË, 4 GUSHT 2025

Ora	Programi	Lokacioni
11:00 deri 19:00	Frank Bölter (GJERMANI) - Origami së bashku Jeni të ftuar t'i bashkëngjiteni artistit për të krijuar një origami të madhësisë reale së bashku	P1: Sheshi "Zahir Pajaziti"
19:00	Ju ftojmë të na bashkëngjiteni në paradën përgjatë bulevardit "Nënë Tereza", për të shoqëruar krijesën origami të krijuar gjatë ditës.	

E MARTË, 5 GUSHT 2025

Ora	Programi	Lokacioni
18:00	Frank Bölter (GJERMANI) - Origami së bashku Krijesën e ditës së djeshme do ta transformojmë, ri - përdorim dhe ri - ciklojmë, duke ri - krijuar diçka të bukur bashkërisht.	P1: Sheshi "Zahir Pajaziti"
18:30	Mimo's Dixie Band (PORTUGALI) - GoGo & StayStay Street Artistët dhe tingujt e tyre të veçantë na sjellin Nju Orlinsin në Prishtinë. Hapu.me ta, luaj dhe bëhu pjesë e këtij përjetimi të veçantë.	P3: Bulevardi "Nënë Tereza" (te Ministria e Kulturës)
20:00	Mimo's Dixie Band (PORTUGALI) - GoGo & StayStay Street Na u bashkoni për mbylljen e Festivalit me artistët nga Portugalia dhe tingujt e tyre frymore të veçantë që na sjellin Nju Orlinsin në Prishtinë. Së bashku edhe me Frank Bölter ju themi "Mirupafshim vitin tjetër"!	P1: Sheshi "Zahir Pajaziti"



LOKACIONET E FESTIVALIT:

GJAKOVË

GJ1 Parku Kulturor “Ali Podrimja”

GJ2 Afër Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi”

PRISHTINË

P1 Sheshi “Zahir Pajaziti”

P2 Sheshi “Skënderbeu”

P3 Bulevardi “Nënë Tereza” (te Ministria e Kulturës)

Qendra e Festivalit:

Teatri ODA, Pallati i Rinisë, 111, Prishtinë

GJAKOVA

GJ2

PALLATI KULTURËS
"ASIM VOKSHI"

NEŊETEREZA

YEŊETERENIKUT

KRENA

PARKU KULTUROR
"ALI PODRIMJA"

GJ1


KRENA

YEŊETERENIKUT

SEFEDIN XËRXA

KRENA

PRISHTINË



Juan Ignacio Tula (FRANCË, ARGJENTINË)

L'INSTANT T!

Në këtë performancë të hapur për hapësirën publike, Juan Ignacio Tula sjell një riformulim të veprës së tij "Instante" – një dialog i vazhdueshëm midis trupit dhe objektit të tij të përhershëm: rrotës. Performanca "Instant-T" shfaqet si një proces i gjallë, në transformim të vazhdueshëm, ku materiali i krijimit kthehet në hapësirë për metamorfozë të pafundme.

Lëvizjet rrotulluese, të thjeshta por hipnotizuese, krijojnë një ritëm të brendshëm që na fton në një udhëtim fizik e meditativ. Brenda këtij rrotullimi, fshihet një tension mes kontrollit dhe dorëzimit, ku trupi sfidon kufijtë e tij dhe e gjen veten në një ekstazë që lidh universalen me personalen.

Kjo është një thirrje për të përjetuar cirkun jo si spektakël të jashtëm, por si një akt të brendshëm kërkimi – ku spiralet e verbra çojnë drejt një instinkti mbijetese, e ku trupi bëhet vegël e pafundësisë.

*Krijuar dhe
performuar nga:*
Juan Ignacio Tula





Foto: Arben Llapashtica

Zëri: Gildas Céleste

Teknika: Célia Idir

Kostumet: Adèle Giard

Produksioni dhe turneu: Kevin-Gabriel Fricot, Andréa Petit-Friedrich - Triptyque Production

Administrata: Anne Delépine

cie7bis.fr

Prezantimi i "L'Instant T" është mbështetur
gjithashtu nga Teatroskop dhe Institut Français në
Paris përmes programit "La Collection".



Tac o Tac (FRANCË)

TAKE OFF (NISJA)

Nga Ikarusi te Njutoni, nga Sputniku te Armstrongi... historia e pushtimit të hapësirës është shoqëruar nga personazhe po aq të guximshëm sa edhe të zgjuar – dhe të gjithë kanë kontribuar në shkrimin e kësaj historie të jashtëzakonshme e që është zbulimi i qiellit!

Por kur tre të çuditshëm vendosin të sfidojnë mitin më prestigjioz të botës moderne, atëherë pushtimi bëhet... "i veçantë."





Autor:
Brice Butane

Performues:
**Lou Dessaint, Karine Cordelle
dhe Brice Butane**

GJAKOVË

E shtunë, 2 gusht 2025

ora 11:00 / GJ1: Parku kulturor "Ali Podrimja"

ora 18:00 / GJ1: Parku kulturor "Ali Podrimja" (Pika Fillestare)

PRISHTINË

E hënë, 4 gusht 2025

ora 11:00 / P1: Sheshi "Zahir Pajaziti"

ora 19:00 / P1: Sheshi "Zahir Pajaziti" (Pika fillestare)

E martë, 5 gusht 2025

ora 18:00 / P1: Sheshi "Zahir Pajaziti"

Frank Bölter (GJERMANI)

ORIGAMI SË BASHKU

Frank Bölter ndoshta do të fluturojë drejt Prishtinës dhe Gjakovës me një aeroplan gjigand prej letre – ose ndoshta do të lundrojë me një anije të madhe prej letre. Një kalë me përmasa më të mëdha se ato reale mund të mbajë brenda disa njerëz. Artisti ju fton t'i bashkoheni. Me ndihmën e publikut, këto krijesa origami në përmasa reale do të palosen së bashku. Sërish, duke bashkëpunuar, këto krijime do të transformohen në lule që zbukurojnë qytetin dhe festojmë me njëri-tjetrin praninë tonë në hapësirën publike.

Kush do të palos?



Foto: Alexander Battrell



Foto: Alexander Battrell



Autor dhe performues:
Frank Bölter.

Mimo's Dixie Band (PORTUGALI)

GOGO & STAYSTAY STREET

"Go Go & Stay Stay" është një performancë e dedikuar për rrugë dhe hapësira të tjera publike. Qoftë duke lëvizur apo në vend, kjo performancë është një festë e vërtetë me tingujt të Dixieland-it që të mbesin në kokë. Atmosfera e rrugëve të vjetra të New Orleans-it, ndërthuret edhe me momente teatrale, mjeshtri cirku si dhe një ndërveprim të ngushtë me publikun.

Duke e shndërruar rrugën në një skenë në lëvizje, Mimo's e sjellin energjinë e tyre pranë publikut, i cili shpeshherë bëhet protagonist i vërtetë i shfaqjes. Muzika, humori dhe dimensionin spektakolar janë gjithmonë të garantuara.

Performuesit:

André Carvalho (Tuba)

Carlos Raposo (Trompetë)

David Valente (Washboard / zhonglim)

Luis Carvalho (Klarinetë)


Miguel Estima (Bateri)





Drejtimi Artistik: David Valente
 Drejtimi Muzikor: Carlos Raposo
 Skenografia: Hugo Ribeiro
 Kostumet: Tucha Martins
 Producent Ekzekutiv: David Calhau
 Fotografite dhe Videot: Pedro Cruz & David Gomes
 Bashkëprodhim: AlbergAR-TE & WETUMTUM
 Shpërndarja: WETUMTUM





FONDACIONI PËR GJAKOVËN

Fondacioni “Për Gjakovën” është një iniciativë e një kolektivi vizionarësh, krijuesish e ambasadorësh kulturorë që janë vënë në lëvizje për të promovuar trashëgiminë kulturore të Gjakovës, duke fuqizuar komunitetin dhe të inspiruar nga kreativiteti kanë ndërmarr iniciativa kulturore e artistike që e kanë shndërruar Gjakovën dhe hapësirën e saj publike në një festë kulturore kuptimplote dhe të veçantë.

Këtë edicion, Teatri ODA në bashkëpunim me Fondacionin “Për Gjakovën” ka shtrirë programin e Festivalit HAPU edhe në Gjakovë, në kuadër të organizimit “Ditët e shqiptarit”, duke ofruar kështu një përvojë unike të krijimeve artistike të dedikuara për hapësirës publike nga artistë ndërkombëtar.

Është një kënaqësi e veçantë të kemi mundësi të ndajmë këto përvoja dhe rrugëtime artistike “Për Gjakovën”.

Për 
Gjakovën
FONDACIONI

<https://fondacionipergjakoven.org/>



@fondacionipergjakoven



Fondacioni Për Gjakovën

IN -SITU PLATFORM

(2025-2028)

Platforma evropiane për krijimtari artistike në hapësira publike

Teatri ODA ka një partneritet të strukturuar me IN SITU, në nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar të krijimeve artistike në hapësirë publike.

IN SITU është Platforma evropiane për krijimtari artistike në hapësira publike. Që nga viti 2003, ka përkrahur rreth 300 artistë që punojnë jashtë hapësirave konvencionale dhe që kontribuojnë në transformimin e territoreve tona. IN SITU është një ekosistem që lidh gjeneratën e re të artistëve me publikun, programuesit dhe akterët kyç të përfshirë në realitetet ekonomike, politike e sociale rreth e përqark Evropës.

Nga viti 2025 deri në 2028, rrjeti IN SITU po zhvillon PLATFORMËN, një program katërvjeçar për të identifikuar dhe mbështetur 200 artistë të rinj që krijojnë në hapësira publike dhe vende jokonvencionale në mbarë Evropën.

I koordinuar nga Lieux publics në bashkëpunim të ngushtë me më shumë se 20 partnerë, PLATFORMA zhvillohet nga viti 2025 deri në 2028 dhe ofron një program mbështetës inovativ dhe efikas për artistë në zhvillim, për të fuqizuar krijimin artistik në nivel evropian, në hapësira publike dhe vende alternative.

Projekti përbëhet nga një konsorcium ndërkombëtar me një entitet koordinues dhe më shumë se 20 partnerë nga 20+ vende në Evropë dhe më gjerë: Austri, Belgjikë, Republika Çeke, Poloni, Danimarkë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Itali, Kosovë, Holandë, Norvegji, Portugali, Spanjë, por edhe Tunizi, Mbretëria e Bashkuar, SHBA, Burkina Faso, Koreja e Jugut dhe Kili.

Gjatë këtyre katër viteve do të organizohen tre cikle, ku secili do të mirëpresë dhe mbështesë rreth 65 artistë, të përzgjedhur përmes thirrjeve të kuruara për aplikim.

Gjithashtu, do të organizohen IN SITU FOCUS, për të prezantuar artistët në zhvillim të rrjetit IN SITU në kuadër të festivaleve ndërkombëtare në Spanjë, Kosovë dhe Austri.



Co-funded by
the European Union


www.in-situ.info



@insituplatform



IN SITU - European Platform for
Artistic Creation in Public Space



HAPU - Festivali i Artit në Hapësirë Publike
organizohet nga Teatri ODA:



TEATRI
ODA

Pallati i Rinisë, 111 (Rinia, 7)
10030 Prishtinë, Kosovë
www.teatrida.com
T: +383 38 246 555
M: +383 49 246 555
E: oda@teatrida.com
f @ teatrida

Drejtor Artistik: Florent Mehmeti
Kordinatore: Renea Begolli
Asistente të produksionit: Arjeta Aliu, Delvina Bytyqi
Ekipi teknik: Bujar Bekteshi, Sabi Paqarizi, Arbresha Caka,
Yann Perregaux-Dielf, Mursel Bekteshi
Administrata: Lumnije Komoni
Kordinatore e Fondacionit "Për Gjakovën": Jeta Gërçari

PARTNERËT E FESTIVALIT:



European platform for artistic
creation in public space

MBËSHETUR NGA:



Republika e Kosovës
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



GOETHE-ZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER



AMBASSADE
DE FRANCE
AU KOSOVO
Liberté
Égalité
Fraternité

ADS D-LINE VM3

SPONZORIZUAR NGA:




LACALUT



ADVANCIS
More than a brand, a way of life

Ky publikim reflekton qëndrimet vetëm të autorëve. Donatorët dhe mbështetësit nuk mbajnë përgjegjësi për çfarëdo përdorimi të informatave që përmban ky publikim.





—
TEATRI
ODA
—